



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 455/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.10.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-59740-06-03-2020, me objekt: “Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës 9,099,219 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ankimues: “Erison Company” shpk
Adresa: Rruga “Shoqëria Bashkimi”, Lagjia Nr. 6, Durrës.

Autoriteti Kontraktor: Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
Adresa: Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 8, Tiranë.

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, pretendimet e tij dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky operator ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.06.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-59740-06-03-2020, me objekt: “*Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje*”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës 9,099,219 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

II.2. Në datën 10.08.2020, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor si dhe sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), rezulton se në datën 17.08.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. “InfoSoft Office”	7,071,000 lekë	kualifikuar
2. “Erison Company”	7,300,300 lekë	kualifikuar
3. “Adenis Kastrati Kastrati”	7,356,000 lekë	skualifikuar
4. “Mond Office”	7,890,100 lekë	skualifikuar
5. “IT Gjergji Kompjuter”	7,911,000 lekë	kualifikuar
6. “Interlogistic”	8,521,308 lekë	kualifikuar
7. “Adastra”	8,759,420 lekë	skualifikuar
8. “Office Center”	9,099,200 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 17.08.2020, operatori ekonomik “Erison Company” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe kualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi.

II.4.1. Në datën 24.08.2020, operatori ekonomik “Erison Company” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kundërshton vendimin e KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk në këtë procedurë prokurimi në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë vijon:

Ne daten 17.08.2020 u njohem me vleresimin e ofertave ne te cilen rezulton renditja si me poshte:

1.	“InfoSoft Office”	7,071,000 lekë	kualifikuar
2.	“Erison Company”	7,300,300 lekë	kualifikuar
3.	“Adenis Kastrati Kastrati”	7,356,000 lekë	skualifikuar
4.	“Mond Office”	7,890,100 lekë	skualifikuar
5.	“IT Gjergji Kompjuter”	7,911,000 lekë	kualifikuar
6.	“Interlogistic”	8,521,308 lekë	kualifikuar
7.	“Adastra”	8,759,420 lekë	skualifikuar
8.	“Office Center”	9,099,200 lekë	skualifikuar

Kunder ketij klasifikimi paraqesim formularin e ankeses brenda afateve ligjore sipas parashikimeve te nenit 63 te ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” te ndryshuar.

1- Kualifikimi i operatorit “Infosoft Office” shpk eshte ne kundërshtim te hapur me frymen e legjislacionit publik pasi ju vete e keni shprehur si me poshte:

Modeli i tonerit i paraqitur ne katalog per artikullin nr. 14 per printerin OKI MB 472 dnë, nuk perputhet me printerin e kerkuar ne specifikimet teknike. Part number i tonerit 45807111 i ofruar nuk i perket modelit te printerit OKI MB 472 dnë te kerkuar ne specifikimet teknike dhe nuk eshte i perdorshem per kete lloj printeri. Bazuar ne shtojcen 10 “Mosplotësimi i specifikimeve për çdo artikull përbën kusht skualifikimi.”

-Mostra e tonerit te paraqitur per artikullin nr. 3, Toner per fotokopje Toshiba e -Studio 222 CP (black) nuk ka te vendosur pulle sigurie. Gjithashtu ne kuti nuk eshte i stampuar emri i prodhuesit.

-Mostra e tonerit te paraqitur per artikullin nr. 15, Toner per Fotokopje Toshiba E studio 307 nuk ka te vendosur pulle sigurie.

Bazuar ne shtojcen 10 te DST “Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit “Genuine”. Emri i prodhuesit te jete i stampuar si ne kutine e bojës, ne pullen e sigurisë ashtu edhe ne kartrixhe , dhe te jete i njejtë emer prodhuesi ne kartrixhe, ne paketimin e bojës dhe ne pullen e sigurisë.”, ky kriter nuk eshte plotësuar.

Modeli i tonerit i paraqitur ne katalog per artikullin nr 14 per printerin OKI MB 472 dë nuk perputhet me printerin e kerkuar ne specifikimet teknike. Part numberi i tonerit 45807111 i ofruar nuk i perket modelit te printerit OKI MB 472 dë te kerkuar ne specifikimet teknike dhe nuk eshte i perdorshem per kete lloj printeri. Po ju paraqesim edhe faktet e pakundershtueshme qe ne kemi gjetur. Per kete lloj printeri nuk ekziston ky lloj part numberi, pra ky kod toneri 45807111 nuk punon ne printerin OKI MB472 dë. Bashkangjitur linku ne faqen zyrtare te OKI europe qe tregon qe ky kod toneri nuk ben per printerin OKI MB 472 dë. <https://ëëë.oki.com/eu/printing/support/consumables-and-accessories/mono-multifunction/45762102/?os=ab2>.

Bazuar ne shtojcen 10 mosplotesimi i specifikimeve per cdo artikull perben kusht skualifikimi.

2- Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ka dorezuar pasqyrat financiare te nje prej 3 viteve te fundit 2016, 2017, 2018, por keto pasqyra nuk jane te shoqeruara me raportin e audituesit te pavaruar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne baze te ligjit 10091 date 05.03.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar, neni 41 te ndryshuar.

Ky operator nuk ka zbatuar detyrimin ligjor per auditimin e pasqyrave financiare.

3- Operatori ekonomik “Infosoft Office” ka paraqitur ne tender shtojcen 5 me vetedeklarim qe ka paguar te gjitha detyrimet per pagimin e tatimeve e te kontributeve te sigurimeve shoqerore, sipas legjislacionit ne fuqi. Sipas te dhenave qe ne kemi, ky operator ekonomik ditën e hapjes se tenderit data 02.06.2020 rezulton qe ka detyrime tatimore te papaguara (kodi 1554 tatim mbi te ardhura nga dividendet dhe aksione gjoba inspektori, evazion fiskal dhe fshehje detyrimesh). Ju si autoritet kontraktor mund te beni verifikimet e nevojshme dhe do te konstatooni te njejtin pretendim qe kemi ngritur ne.

4- Ky operator nuk ka paraqitur vertetimin e konfirmon shlyerjen e te gjitha detyrimeve te maturuara te energjise elektrike te kontratave te energjise qe ka operatori ekonomik qe eshte i regjistruar ne Shqiperi.

5- Nuk ka paraqitur mostrat e produkteve sipas kodeve te percaktuara ne shtojcen 10 per zerat me nr. 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17. Modeli i Tonerit/Part Numberi duhet te jete i stampuar ne kuti dhe te jete i njejte sipas shtojces “Specifikimet Teknike” gje qe nuk eshte zbatuar nga Infosoft Office.

Nr .	PRINTER & FOTOKOPJE	MODELI I TONERIT	Nr.Kopjeve	Njesia	Sasia e pritshm e
1	Toner per printer HP LaserJet 1150	(Q2624A)	2500	cope	10
2	Toner per printer Oki B430	43979202/43979211	7000	cope	1
3	Toner per fotokopje Toshiba e -	TFC26SK3K	3000	cope	34

	Studio 222 CP (black)				
4	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (color)	TFC26SC2K	2000	cope	24
5	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (color)	TFC26SM2K	2000	cope	24
6	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (color)	TFC26SY2K	2000	cope	24
7	Toner per printer Xerox Phaser 3600	106R01371	14000	cope	94
8	Toner per printer Xerox Phaser 3250	106R01374	5000	cope	161
9	Toner per printer Kyocera P2135 DN	TK-170	7200	cope	211
10	Toner per printer Lexmark MS310/312dn	50F2H00	5000	cope	73
11	Toner per printer HP Laserjet Pro 400MFP	CF280X	6900	cope	50
12	Toner per fotokopje Ricoh Aficio MP 301SP	Type MP301E	8000	cope	10
13	Toner per printer Xerox Phaser 3025	106R02773	1300	cope	12
14	OKI MB 472 dnë	45807111	12000	cope	12
15	Toner per Fotokopje Toshiba E studio 307	T5070E	36600	cope	134
16	Toner per Fotokopje Xerox Eöorkcentre 5330	006R01160	30000	cope	3
17	Toner per printer Xerox Versalink B7030	106R03396	30000	cope	20
18	Toner per printer KYOCERA FS6525MPF	TK -475	15000	cope	12
19	Toner per printer Xerox Eöorkcentre 3335	106R03623	15000	cope	10

6- Ky operator nuk ka paraqitur deklarate qe permbush keto kritere si me poshte:

Tonerat/Bojerat duhet te evidentohen nepermjet Part-Numberit perkates;.,

Tonerat/Bojerat te jene origjinale OEM, te jene te reja, te mos jene te rimbushura (Recondition); te mos jene te ricikluara (Remanufactured); te mos jene te riprodhuara; te jene te paketuara e te pahapura.

Tonerat/Bojerat duhet te permbajne pullen e sigurise se prodhuesit "Genuine". Emri i prodhuesit te jete i stampuar si ne kutine e bojes, ne pullen e sigurise ashtu edhe ne kartrixhe, dhe te jete i njejti emer prodhuesi ne kartrixhe, ne paketimin e bojes dhe ne pullen e sigurise.

7- Ky operator nuk ka paraqitur deklaratën që bojrat të kënaqshme afat skadence jo më pak se 1 vit nga momenti i levrimit të mallit.

Kerkojme nga Autoriteti Kontraktor pranimin e ankesës tone për skualifikimin e “Infosoft Office”.

II.4.2. Me shkresën Nr. 6359/3 prot, datë 26.08.2020 autoritetit kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Erison Company” shpk ku ka vendosur refuzimin e ankesës së bërë prej tij pranë autoritetit kontraktor.

II.4.3. Në datën 04.09.2020 operatori ekonomik ankimues “Erison Company” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 6694/1 prot., datë 16.09.2020, protokolluar me tonën me numër 1065/2 prot., datë 17.09.2020, me objekt “Informacion” si dhe me shkresën nr. 7444/1 prot, datë 12.10.2020, protokolluar me tonën me numër 1065/4 prot, datë 13.10.2020 me objekt “Dërgim mostrash” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor si dhe mostrat lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “Infosoft Office” shpk, me arsyetimin se: “Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ka dorëzuar pasqyrat financiare të një prej 3 viteve të fundit 2016, 2017, 2018, por këto pasqyra nuk janë të shoqëruara me raportin e audituesit të pavaruar në përputhje me legjislacionin në fuqi në bazë të ligjit 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, nëni 41 të ndryshuar. Ky operator nuk ka zbatuar detyrimin ligjor për auditimin e pasqyrave financiare”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 9/2 të modifikuar “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” pika 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Ishte: Pika 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

a) Deklaratë për xhiron mesatare vjetore të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2017, 2018, 2019) ku vlera e saj të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit.

b) Kopje bilanci të një prej 3 (tri) viteve të fundit (2016, 2017, 2018) nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi të pranuar nga autoritetet përkatëse.

Bëhet: Pika 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar

a) Deklaratë për xhiron mesatare vjetore të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2017, 2018, 2019) ku vlera e saj të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit.

b) Kopje bilanci të një prej 3 (tri) viteve të fundit (2017, 2018, 2019) nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedure prokurimi të pranuar nga autoritetet përkatëse.

III.1.2. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike operatori ekonomik “Infosoft Office” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1- Shkresë nr. 7027 prot datë 03.04.2017 nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për konfirmimin e pasyrave financiare të shoqërisë “Infosoft Office” sh.p.k shpk për vitin 2016.
- Pasqyrat Financiare për vitin 2016 të konfirmuara nga administrata tatimore së bashku me raport auditin.

2- Shkresë nr. 563 prot datë 12.04.2018 nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për konfirmimin e pasyrave financiare të shoqërisë “Infosoft Office” shpk për vitin 2017.
- Pasqyrat Financiare për vitin 2017 të konfirmuara nga administrata tatimore së bashku me raport auditin.

3- Shkresë nr. 422 prot datë 01.04.2019 nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për konfirmimin e pasyrave financiare të shoqërisë “Infosoft Office” shpk për vitin 2018.
- Pasqyrat Financiare për vitin 2018 të konfirmuara nga administrata tatimore së bashku me raport auditin.

4- Shkresë nr. 546 prot datë 13.07.2020 nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj për konfirmimin e pasyrave financiare të shoqërisë “Infosoft Office” shpk për vitin 2019.
- Pasqyrat Financiare për vitin 2019 të konfirmuara nga administrata tatimore së bashku me raport auditin.

5- Vërtetim Nr. T02678316 datë 05.08.2020 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM në emër të subjektit “Infosoft Office” sh.p.k. ku raportohen të ardhurat nga shitja e mallrave/shërbimeve për vitet 2017, 2018 dhe 2019.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gëmbra “b” e Ligjit nr.9643, dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet,

nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur”.

III.1.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji”.*

III.1.5. Në ligjin 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” neni 41 të ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *“Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:*

a) të gjitha shoqëritë tregtare, pavarësisht nga forma e tyre, të cilat zbatojnë standardet ndërkombëtare të raportimit financiar;

b) të gjitha shoqëritë aksionare, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit;

c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;

ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;

iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, gjykojmë se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.1.7. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, KPP mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” sh.p.k. dhe verifikimin nëse ky operator përmbush dy nga kushtet kumulative të parashikuara në ligjin e sipërcituar për auditimin e pasqyrave financiare. KPP referuar pasqyrave financiare të dorëzuara nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” sh.p.k. konstaton se totali i aktiveve të bilancit për vitin 2017, 2018, 2019 e kalon shumën e përcaktuar nga ligjvënësi.

Gjithashtu referuar vërtetimit Nr. T02678316 datë 05.08.2020 të lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve DTM ky subjekt ka raportuar të ardhura nga shitja e mallrave/shërbimeve për vitet 2017, 2018 dhe 2019, disa herë më shumë se sa vlera e përcaktuar në legjislacionin përkatës.

Sa më sipër, KPP gjykon se, operatori ekonomik “*Infosoft Office*” sh.p.k. ka plotësuar dy nga kushtet kumulative të vendosura nga legjislacioni në fuqi, për kryerjen e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore për vitet 2017, 2018, 2019 përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese. KPP, gjykon se nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “*Infosoft Office*” sh.p.k. rezulton se, janë dorëzuar pasqyrat financiare për vitet e fundit (2016-2017-2018-2019), kërkesë kjo e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe këto pasqyra financiare janë të shoqëruara edhe me raportin e audituesit të pavarur në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në këto kushte KPP gjykon se, ky operator ekonomik e ka zbatuar detyrimin ligjor për auditimin e pasqyrave financiare për vitet 2017, 2018, 2019, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore të mësipërcituara.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Erisoni Company*” shpk nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Erisoni Company*” shpk për kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së shoqërisë “*Infosoft Office*” shpk, me arsyetimin se: “*Operatori ekonomik “Infosoft Office” ka paraqitur ne tender shtojcën 5 me vetedeklarim që ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Sipas të dhënave që kemi, ky operator ekonomik ditën e hapjes së tenderit data 02.06.2020 rezulton që ka detyrime tatimore të papaguara (kodi 1554 tatim mbi të ardhura nga dividendet dhe aksione gjoba inspektori, evazion fiskal dhe fshehje detyrimesh). Ju si autoritet kontraktor mund të beni verifikimet e nevojshme dhe do të konstatooni të njejtin pretendim që kemi ngritur ne.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 9 “*Kriteret e Përgjithshme të Pranimet/Kualifikimit*”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar si më poshtë vijon:

Shtojca 9

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) *Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.*
- b) *nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv).*
- c) *nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP.*
- ç) *nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

III.2.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik ankimes “InfoSoft Office” sh.p.k ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme në të cilën në pikën e fundit të saj ka deklaruar: “Operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k. ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi. Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.”

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.2.4. Në nenin 45, pika 2, gërmat “d” dhe “dh” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Çdo kandidat ose ofertues përjashtohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi, në rastet kur:

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës”.

III.2.5. Në lidhje me pretendimin e mësipërm të operatorit ekonomik ankimues, në informacionin e autoritetit kontraktor dërguar pranë KPP me shkresën nr. 6694/1 prot që mban datën 16.09.2020, rezulton se autoriteti kontraktor i është drejtuar me kërkesë operatorit ekonomik *“InfoSoft Office”* me përmbajtje si vijon *“Komisioni i ngritur për shqyrtimin e ankesës pasi verifikoi dokumentacionin e tenderit në sistem, kërkon informacion nëse ju dispononi dokumenta ligjor, vërtetim etj., që nuk mbartni detyrime tatimore, pasi në dokumentat e tenderit keni dorëzuar vetdeklarim me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas shtojcës 8, në të cilën deklaroni se nuk keni detyrime tatimore”*, duke marrë shkas nga kërkesa e autoritetit kontraktor në informacionin e autoritetit kontraktor ardhur pranë KPP me shkresën nr. 6694/1 prot që mban datën 16.09.2020, rezulton se operatori *“InfoSoft Office ka dërguar një vërtetim me nr. 1372 prot, date 06.08.2020 nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve DTM ku vërtetohet se InfoSoft Office nuk ka detyrime tatimore në Tatimin mbi vlerën e shtuar, Tatimin mbi Fitimin, Kontribute të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore, Tatim mbi të ardhurat Personale por ka detyrime (gjoha) në Tatimin në burim në shumën 815.500 lekë për të cilat ndodhet në proces gjyqësor apelimi administrativ. Shoqeria InfoSoft Office ka vënë në dispozicion gjithashtu një vendim të Gjykatës Administrative të shkallës së Parë Tiranë ku kjo shoqëri është në cilësinë e palës paditëse dhe palë e paditur është Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj ku Gjykata ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesë padisë..”*

III.2.6. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.2.7. Referuar sa më sipër Komisioni konstaton se për plotësimin e kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit parashikuar në shtojcën 8/1, autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë që të plotësojnë dhe dorëzojnë shtojcën 5 vetëdeklaratën me shkrim të subjektit për plotësimin e kriterëve të parashikuar në shtojcën 8/1 të dokumentave të tenderit. KPP konstaton se operatori ekonomik *“InfoSoft Office”* shpk ka dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike shtojcën 5 *“Deklaratë mbi Përmbushjen e Kriterëve të Përgjithshme”*, për të cilat operatori ekonomik *“Erisoni Company”* pretendon se në ditën e hapjes së tenderit datën 10.08.2020 ka detyrime tatimore të papaguara.

III.2.8. Duke qenë se një situatë e tillë nuk rregullohet nga lex specialis, ligji nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”* të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për interpretimin e togfjalëshit *“detyrim tatimor”* në rastet kur akti administrativ *“Njoftim vlerësimi tatimor”* është në proces ankimi, do të konsiderohet ose jo *“detyrim”* për qëllim të kualifikimi në procedurat e prokurimit publik, gjykon ti drejtohet për interpretim sistematik (*domethënjen e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brënda sistemit juridik*). Për të arritur në vendimarrje të drejtë, K.P.P. gjykon se duhet ti drejtohet,

ligjit të posaçëm (*lex specialis*) Ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSh” të ndryshuar, në nenin 6 pika 3 parashikon se “Me detyrim tatimor” nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjrobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”.

Komisioni i Prokurimit Publik, për të arritur në vendimarrje vlerësoi se duhej të kishte parasysh:

- jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese (shiko Vendimin nr.16, datë 25.07.2008) - në bazë së të cilës janë bërë dhe ndryshime në legjislacionin tatimor;
- Vendimin Unifikues nr.4, datë 30.05.2011 të Gjykatës së Lartë – i cili shprehet se:

“Me “detyrim tatimor”, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 6/3 nënkupton “tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjrobat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”.

Dallohet qartësia në ligj që, për t’u marrë në shqyrtim ankimi, detyrimisht duhet që të parapaguhet, sipas aktit administrativ Njoftim-Vlerësimit, detyrimi tatimor, i cili duhet të ketë të përfshirë tatimin dhe kamatëvonesat.

Gjrobat, megjithëse konsiderohen sipas nenit të cituar, si pjesë e detyrimit tatimor, nuk përfshihen, si pjesë e parapagimit të detyrimit, si një kusht i domosdoshëm për të marrë në shqyrtim ankimin administrativ.”.

- Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSh” (ndryshuar me Ligj Nr. 179/2013, dt. 28.12.2013), neni 107 i të cilit parashikon se:

1. “Tatimpaguesi, i cili kërkon të ankimojë, sipas pikës 1 të nenit 106 të këtij ligji, duhet që bashkë me ankesën të paguajë shumën e plotë të detyrimit tatimor ose të vendosë garanci bankare për shumën e plotë të detyrimit tatimor, të përcaktuar në njoftimin e vlerësimit të administratës tatimore.

2. Shuma e pagueshme ose shuma e vënë si garanci bankare, sipas pikës 1 të këtij neni, përjashton gjrobat e përfshira në vlerësimin tatimor të ankimuar.

3. Ankimi merret në shqyrtim vetëm kur tatimpaguesi ka paguar detyrimin tatimor, që është objekt i ankimit, ose ka paraqitur dokumentin bankar që vërteton vendosjen e garancisë, sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij neni.”.

- Udhëzimin nr.24, datë 02.09.2008 të Ministrisë të Financave që parashikon se:

“Shuma e detyrimit për t’u paguar përfshin vetëm shumën e tatimit dhe interesin, nëse ka, në aktin administrativ që ankimohet, që është i pagueshëm në momentin e ankimit, duke përjashtuar gjrobat e përfshira në aktin administrativ objekt ankimi”. Bazuar në gjithë sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se “operatori ekonomik InfoSoft Office ka detyrime tatimore të pashlyera”, kur me këto të fundit nënkuptohen gjropa të cilat janë në proces ankimi, nuk është në përputhje me frymën e legjislacionit për prokurimin publik. Komisioni vlerëson të adoptojë një interpretim të ngushtë e teleologjik të togflalëshit “detyrimet për pagimin e tatimeve” të parashikuar nga neni 45, pika

2, gërma “dh” i Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), në funksion të një prej qëllimeve të këtij ligji, që është nxitja e pjesëmarrjes dhe e konkurrencës së operatorëve ekonomikë, në kuptim të rritjes së efikasitetit të procedurave të prokurimit publik. Në balancën mes përpjekjes për të siguruar pagesën e plotë të të gjithë elementëve të detyrimit tatimor, nga njëra anë, dhe mirpërdorimin e fondeve publike – që arrihet përpara së gjithash përmes një pjesëmarrje të gjerë e konkurruese të operatorëve ekonomikë, nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ato raste kur nga operatori pjesëmarrës në procedurën e prokurimit është paguar tatimi përkatës dhe interesi, ndërkohë që gjopa është në proces ankimi, nuk mund të ngrihet si pretendim dhe të shërbej si arsye skualifikimi.

Sa më sipër, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në S.P.E. nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k. vërtetohet se ka shlyer të gjithë detyrimet tatimore në fuqi. Kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Pra, KPP gjykon se operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k., i përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes “Erisoni Company” shpk nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Erisoni Company” shpk mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “Ky operator nuk ka paraqitur vërtetimin e konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 9/2 “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” pika dh) të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik “InfoSoft Office” sh.p.k në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim Debie nr. 6032/1 prot., datë 23.07.2020, ku citohet: [...] Bazuar në deklaratimet e deklaruesit... vërtetojmë se kërkuesi “InfoSoft Office” nga verifikimet e kryera në Sistemin e Faturimit, për kontratën /kontratën me kod TR1C110110052293, titullar i së cilës/cilave është Inter-Ofiss, TR2A120169639638, përdorues i së cilës/cilave është “InfoSoft Office” shpk, TR3V160284650485 titullar i së cilës/cilave është “InfoSoft

Office” shpk rezulton të ketë në total 0 lekë detyrime për faturat e energjisë elektrike, vlerë e llogaritur deri në datën 23.07.2020 përfshirë faturën koherente të muajit Qershor 2020.

III.3.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit..*

III.3.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27, pika 5, gërma “c”, përcaktohet se: *“Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: “c) një vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Mosshlyerja e detyrimeve të energjisë elektrike përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik, përveç rastit kur rezulton se detyrimet e papaguara të energjisë elektrike, të konfirmuara në vërtetimin e lëshuar nga furnizuesi, janë në proces ankimi në gjykatë. Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik.*

III.3.5. Në nenin 9 (“Pagesa dhe afati për kryerjen e saj”), paragrafi 9.1, të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 “Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë”, përcaktohet shprehimisht që: *“Klienti do të paguajë detyrimin e përcaktuar në faturën mujore të konsumit të energjisë elektrike (titull ekzekutiv), si dhe kur është rasti, kamatëvonesat përkatëse dhe pagesën e rilidhjes së energjisë, jo më vonë se ditën e fundit kalendarike të muajit pasardhës të atij të faturuar.*

III.3.6. Referuar korrespondencës që Komisioni i Prokurimit Publik ka pasur me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, është vënë në dijeni nga kjo e fundit, se pasi bëhen verifikimet përkatëse lëshohet “Vërtetim Debie” sipas formatit standard për të gjitha subjektet aplikuese.

“[...] Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike lëshon vërtetimet e debisë, bazuar në deklaratimet vullnetare të subjekteve kërkuar të kontratave të energjisë elektrike. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektike evidenton saktësinë e dokumentacionit të paraqitur si më poshtë:

- 1. Tërësinë e kontratave të deklaruara nga subjekti (në rast se mund të ketë kontrata të tjera të padeklaruara).*
- 2. Kontratat e furnizimit për objektet e tyre, duhet të jenë të tarifuara si private.*

3. Kontratat e furnizimit duhet të jenë në emër të subjektit, përveç rasteve kur ato janë ambiente të marra me qira.

Në rast se subjekti ka paraqitur kontrata familiare, Operatori i kërkon këtij të fundit ndryshimin e tarifimit dhe pagesën me faturën e ardhshme të diferencës së cmimit bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kontratën e furnizimit me energji elektrike. Të gjithë operatorët që kërkojnë të pajisen me Vërtetimin e Debisë duhet të aplikojnë pranë Qendrave të KNK në të gjithë Shqipërinë dhe lëshimi do të jetë i mundur jo më vonë se pesë ditë pas kërkesës nga subjekti. Mosplotësimi i kritereve të mësipërme do të rezultojë me moslëshimin e Vërtetimit të Debisë nga Drejtoria Qëndrore ose Drejtoritë Rajonale. Modeli zyrtar i lëshimit të Vërtetimit të Debisë në të gjitha rastet e statusit të Operatorëve përmbledh informacionin përkatës për rastet kur:

1. Konsumatori nuk rezulton debitor në Sistemin e Faturimit.

2. Konsumatori rezulton debitor.

3. Konsumatori rezulton debitor por ka lidhur një aktmarrëveshje për shlyerjen e detyrimeve me këste.

4. konsumatori rezulton debitor por është në proces ankimimi dhe ankesa është në trajtim nga strukturat e OSHEE-së.

5. Konsumatori rezulton debitor por vlera është e ankimuar në gjykatë. [...]"

III.3.7. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se përmes dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik "InfoSoft Office" sh.p.k vërteton se ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Referuar datës së zhvillimit të procedurës së prokurimit përkatësisht 10.08.2020 dhe Nenit 9, paragrafi 1 ("Pagesa dhe afati për kryerjen e saj"), të kontratës së miratuar me Vendimin e ERE nr.109, datë 21.10.2011 "Për miratimin e kontratës së furnizimit me energji elektrike të klientëve jofamiljarë", operatori ekonomik "InfoSoft Office" sh.p.k ka përmbushur detyrimet ligjore për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike. KPP gjykon se institucioni i OSHEE-së menaxhon sistemin e të dhënave për pagimin e energjisë elektrike për të gjithë subjektet përdoruese të energjisë elektrike për të gjithë kontratat e lidhura midis OSHEE-së dhe subjekteve përdoruese të energjisë elektrike.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Erisoni Company" shpk nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Erisoni Company" shpk mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik "InfoSoft Office" shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se "Ky operator nuk ka paraqitur deklarate që përmbush keto kritere si me poshte: Tonerat/Bojerat duhet të evidentohen nepermjet Part-Numberit perkates; Tonerat/Bojerat të jene origjinale OEM, të jene të reja, të mos jene të rimbushura (Recondition);. Te mos jene të ricikluara (Remanufactured); te mos jene të riprodhuara; te jene të paketuara e të pahapura;. Tonerat/Bojerat duhet të përmbajne pullen e sigurise se prodhuesit "Genuine". Emri i prodhuesit të jete i stampuar si ne kutine e bojës, ne pullen e sigurise ashtu edhe ne kartrixhe, dhe të jete i njejtë emer prodhuesi ne

kartrixhe, ne paketimin e bojës dhe ne pullën e sigurisë;. Bojrat të këna afat skadence jo më pak se 1 vit nga momenti i levrimit të mallit.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 9/2 të modifikuar “Kriteret e Vecanta për Kualifikim” pika 2.3/c “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Ishte: Pika 2.3.gërma c) Kapaciteti Teknik

c) Deklaratë nga operatori ekonomik e cila të përmbajë që tonerat dhe bojërat përmbushin këto kritere:

Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës.

Tonerat/Bojërat të jënë origjinale OEM, të jënë të reja, të mos jënë të rimbushura (Recondition); të mos jënë të ricikluara (Remanufactured); të mos jënë të riprodhuara; të jënë të paketuara e të pahapura.

Bëhet: Pika 2.3.gërma c) Kapaciteti Teknik

c) Deklaratë nga operatori ekonomik e cila të përmbajë që tonerat dhe bojërat përmbushin këto kritere:

Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës.

Tonerat/Bojërat të jënë origjinale OEM, të jënë të reja, të mos jënë të rimbushura (Recondition); të mos jënë të ricikluara (Remanufactured); të mos jënë të riprodhuara; të jënë të paketuara e të pahapura.

Për artikujt toner me kod CF280X dhe 50F2H00 operatori ekonomik mund të paraqesë Kode ekuivalente.

III.4.2. Në shtojcën 10 të modifikuar “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Ishte: Shtojca 10 tek Specifikimet Teknike:

Tonerat/Bojërat të jënë origjinale OEM, të jënë të reja, të mos jënë të rimbushura (Recondition); të mos jënë të ricikluara (Remanufactured); të mos jënë të riprodhuara; të jënë të paketuara e të pahapura.

Për artikujt me kod CF280X dhe 50F2H00 operatori ekonomik mund të paraqesë Kode ekuivalente, dmth me të njëjtat specifikime, kapaciteti printimi, dhe të jete funksional për paisjen.

Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit “Genuine”. Emri i prodhuesit të jete i stampuar si në kutinë e bojës, në pullën e sigurisë ashtu edhe në kartrixhe , dhe të jete i njëjti emer prodhuesi në kartrixhe, në paketimin e bojës dhe në pullën e sigurisë..

Për bojërat Likuide duhet të shprehet data e skadencës së tyre.

Bojrat të kenë afat skadence jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimit të mallit.

Modeli i Tonerit/Part Numberi duhet të jete i stampuar ne kuti dhe të jete i njejte sipas shtojces "Specifikimet Teknike".

Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese Certifikatën e menaxhimit të cilësisë, ISO 9001:2015 per te gjithë produktet.

Certifikatat kerkohet të jete të vlefshme ne kohen e zhvillimit të tenderit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me Certifikatën e menaxhimit të cilësisë, ISO 9001:2015,ne fushen e objektit të prokurimit Certifikata kerkohet të jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit të tenderit.

Bëhet: Shtojca 10 tek Specifikimet Teknike:

Tonerat/Bojërat të jete origjinale OEM, të jete të reja, të mos jete të rimbushura (Recondition); të mos jete të ricikluara (Remanufactured); të mos jete të riprodhuara; të jete të paketuara e të pahapura.

Për artikujt me kod CF280X dhe 50F2H00 operatori ekonomik mund të paraqese Kode ekuivalente, dmth me të njejtat specifikime, kapaciteti printimi, dhe të jete funksional per paisjen.

Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit "Genuine". Emri i prodhuesit të jete i stampuar si ne kutine e bojës, ne pullen e sigurisë ashtu edhe ne kartrixhe , dhe të jete i njejtë emer prodhuesi ne kartrixhe, ne paketimin e bojës dhe ne pullen e sigurisë.

Për bojërat Likuide duhet të shprehet data e skadencës së tyre.

Bojrat të kenë afat skadence jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimit të mallit.

Modeli i Tonerit/Part Numberi duhet të jete i stampuar ne kuti dhe të jete i njejte sipas shtojces "Specifikimet Teknike".

Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur me Certifikatën e menaxhimit të cilësisë, ISO 9001:2015,ne fushen e objektit të prokurimit Certifikata kerkohet të jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit të tenderit.

III.4.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik "InfoSoft Office" shpk ka dorëzuar Deklaratën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.c të dokumentave standarte të procedurës së prokurimit objekt ankimi me përmbajtjen si më poshtë:

I- Lenda: Deklarate

Drejtuar: Fondi i Sigurimit te Detyrueshem te Kujdesit Shendetesor (FSDKSH)

Me ane te ketij dokumenti, "InfoSoft Office" shpk deklaroi se malli i ofertuar ne proceduren e prokurimit objekt "Blerje artikuj tonera per printera dhe fotokopje", ploteson te gjitha kerkesat dhe specifikimet teknike te percaktuara nga ju.

Marrim persiper qe tonerat dhe bojerat permbushin keto kritere:

Tonerat/Bojerat evidentohen neperrnjete Part-Numberit perkates.

Tonerat/Bojerat jane origjinale OEM, jane te reja, nuk jane te rimbushura (Recondition); nuk jane te ricikluara (Remanufactured); nuk jane te riprodhuara; jane te paketuara e te pahapura.

Per artikujt me kod CF280X dhe SOF2HOO operatori ekonomik mund te paraqese Kode ekuivalente, dmth me te njejtat specifikime, kapaciteti printimi, dhe te jete funksional per paisjen.

Tonerat/Bojerat permbajne pullen e sigurise se prodhuesit "Genuine". Emri i prodhuesit eshte i stampuar si ne kutine e bojës, ne pullen e sigurise ashtu edhe ne kartrixhe, dhe eshte i njejti emer prodhuesi ne kartrixhe, ne paketimin e bojës dhe ne pullen e sigurise.

Per bojerat Likuide shprehet data e skadences se tyre.

Bojrat kane afat skadence jo me pak se 1 vit nga momenti i levrimit te mallit.

Modeli i Tonerit/Part Numberi eshte i stampuar ne kuti dhe eshte i njejte sipas shtojces "Specifikimet Teknike".

2- Shtojcën 6 Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike.

III.4.4. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese".

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: "Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e percaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....".

III.4.5. Referuar sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik "InfoSoft Office" shpk plotëson kriterin e vecantë të kualifikimit, kapaciteti teknik pikën 2.3.c të dokumentave standarte të tenderit, pasi ka paraqitur "Deklaratë me përmbajtje që tonerat dhe

bojrat përmbushin kriteret: *Tonerat/Bojërat duhet të evidentohen nëpërmjet Part-Numberit përkatës. Tonerat/Bojërat të jene origjinale OEM, të jene të reja, të mos jene të rimbushura (Recondition); të mos jene të ricikluara (Remanufactured); të mos jene të riprodhuara; të jene të paketuara e të pahapura. Tonerat/Bojërat duhet të përmbajnë pullën e sigurisë së prodhuesit "Genuine". Emri i prodhuesit të jete i stampuar si në kutinë e bojës, në pullën e sigurisë ashtu edhe në kartrixhe , dhe të jete i njejtë emër prodhuesi në kartrixhe, në paketimin e bojës dhe në pullën e sigurisë. Për bojërat Likuide duhet të shprehet data e skadencës së tyre. Bojrat të kenë afat skadence jo më pak se 1 vit nga momenti i lëvrimin të mallit. Modeli i Tonerit/Part Numberi duhet të jene i stampuar në kuti dhe të jete i njejtë sipas shtojcës "Specifikimet Teknike".*, pjesë e dokumentave të tenderit. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me kërkesat e dokumentave të tenderit dhe legjislacionin në fuqi.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Bazuar në nenin 1 dhe nenin 2 të LPP, në të cilët përcaktohet përkatësisht: *"Qëllimi i këtij ligji është: [...] të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik"; "Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve"*, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues *"InfoSoft Office"* shpk ka paraqitur Deklaratën mbi përmbushjen e kriterëve për mallrat objekt prokurimi të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit kapaciteti teknik pika 2.3.c sipas parashikimeve të bëra nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër KPP gjykon se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik *"InfoSoft Office"* sh.p.k është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi kriteri për paraqitjen e Deklaratës së mallrat objekt prokurimi përmbushin kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, plotësohet nga operatori ekonomik *InfoSoft Office"* sh.p.k.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*Erisoni Company*” shpk nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “*Erisoni Company*” shpk mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “*InfoSoft Office*” shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se “*Nuk ka paraqitur mostrat e produkteve sipas kodeve të percaktuara në shtojcën 10 për zerat me nr. 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17. Modeli i Tonerit/Part Numberi duhet të jete i stampuar në kuti dhe të jete i njëjte sipas shtojcës “Specifikimet Teknike” gje që nuk është zbatuar nga “Infosoft Office”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.5.1. Në shtojcën 9/2 “*Kriteret e Vecanta për Kualifikim*” pika 2.3.b të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

b) Për vlerësimin e ofertës teknike, Operatori ekonomik duhet të dorëzojë pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në AK mostrat e produkteve sipas zerave me nr. 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17, të listës së artikujve të kërkuar në këtë procedurë prokurimi ditën dhe orën e zhvillimit të tenderit të shoqëruar me autorizim dhe me procesverbalin e dorëzimit të artikujve. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

- *Ky do të jetë një kusht për skualifikim në rast se nuk do të paraqiten mostrat, do të ketë mangësi në produktet e dorëzuara ose nuk do të ketë përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.*

Per artikujt që nuk kerkohen mostra, të paraqitet katalog/broshure, ku të shprehet qarte, me foto, specifikime dhe part number, toneri që oferton.

III.5.2. Në shtojcën 10, “*Specifikimet teknike*”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Specifikimi i Materialeve dhe Sasitë e parashikuara për prokurim, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	PRINTER & FOTOKOPJE	MODELI I TONERIT	Nr.Kopjeve	Njesia	Sasia e pritshme
1	Toner per printer HP LaserJet 1150	(Q2624A)	2500	cope	10
2	Toner per printer Oki B430	43979202/43979211	7000	cope	1
3	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (black)	TFC26SK3K	3000	cope	34
4	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (color)	TFC26SC2K	2000	cope	24
5	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (color)	TFC26SM2K	2000	cope	24
6	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (color)	TFC26SY2K	2000	cope	24
7	Toner per printer Xerox Phaser 3600	106R01371	14000	cope	94
8	Toner per printer Xerox Phaser 3250	106R01374	5000	cope	161
9	Toner per printer Kyocera P2135 DN	TK-170	7200	cope	211
10	Toner per printer Lexmark MS310/312dn	50F2H00	5000	cope	73
11	Toner per printer HP Laserjet Pro 400MFP	CF280X	6900	cope	50
12	Toner per fotokopje Ricoh Aficio MP 301SP	Type MP301E	8000	cope	10
13	Toner per printer Xerox Phaser 3025	106R02773	1300	cope	12
14	OKI MB 472 dnë	45807111	12000	cope	12
15	Toner per Fotokopje Toshiba E studio 307	T5070E	36600	cope	134
16	Toner per Fotokopje Xerox Ëorkcentre 5330	006R01160	30000	cope	3
17	Toner per printer Xerox Versalink B7030	106R03396	30000	cope	20
18	Toner per printer KYOCERA FS6525MPF	TK -475	15000	cope	12
19	Toner per printer Xerox Ëorkcentre 3335	106R03623	15000	cope	10

Mosplotësimi i specifikimeve për çdo artikull përbën kusht skualifikimi.

Për vlerësimin e ofertës teknike, Operatori ekonomik duhet të dorëzojë pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në AK mostrat e produkteve sipas zerave me nr. 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17, të listës së artikujve të kërkuar në këtë procedurë prokurimi ditën dhe orën e zhvillimit të tenderit të shoqëruar me autorizim dhe me procesverbalin e dorëzimit të artikujve. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit

Ky do të jetë një kusht për skualifikim në rast se nuk do të paraqiten mostrat, do të ketë mangësi në produktet e dorëzuara ose nuk do ketë përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Per artikujt qe nuk kerkohen mostra, te paraqitet katalog/broshure, ku te shprehet qarte, me foto, specifikime dhe part number, toneri qe oferton.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.5.4. Në nenin 55, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet: “2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.”.

III.5.5. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht: *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:*

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*
- c) *c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.5.6. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.5.7. Referuar kriterit të vecantë të kualifikimit rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqesin mostrat për artikujt e zëravë 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17, të cilat duhet të jenë në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara për secilin artikull. Ndërsa në specifikimet teknike të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi rezulton se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë; Toner per fotokopje Toshiba e -Studio 222 CP (black) modeli i tonerit TFC26SK3K; Toner per printer Xerox Phaser 3600 modeli i tonerit 106R01371; Toner per printer Xerox Phaser 3250 modeli i tonerit 106R01374; Toner per printer Kyocera P2135 modeli i tonerit DN TK-170; Toner per printer Lexmark MS310/312dn modeli i tonerit 50F2H00; Toner per printer HP Laserjet Pro 400MFP modeli i tonerit CF280X; Toner per Fotokopje Toshiba E studio 307 modeli i tonerit T5070E; Toner per printer Xerox Versalink B7030 modeli i tonerit modeli i tonerit 106R03396. Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 6694/1 prot datë 16.09.2020 rezulton se bashkangjitur informacionit të autoritetit kontraktor gjëndet edhe procesverbali i marrjes në dorzim të mostrave i firmosur nga perfaqësuesi i autorizuari i operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk dhe përfaqësuesi i autoritetit kontraktor i cili mban datën 07.08.2020, gjithashtu autoriteti kontraktor ka percjellur fizikisht pranë Komisionit Prokurimit Publik mostrat e kërkuara në dokumentat standarte te tenderit me shkresën nr. 7444/1 prot, datë 12.10.2020, protokolluar me tonën me nr. 1065/4 prot, datë 13.10.2020, dhe nga verifikimi i kryer rezulton se jane paraqitur mostrat e kërkuara për zërat nr. 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17, te listës se artikujve të kërkuar, në

përputhje me specififikimet teknike të parashikuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit. Gjithashtu në informacionin e përcjellur pranë KPP nga autoritetit kontraktor rezulton edhe korrespondenca e ketij te fundit me kompanin BNT Electronics distributori zyrtar i Toshiba Tec Germany, me përmbajtje si më poshtë cituar: *“Në datë 13.08.2020 me anë të shkresës nr 6243 prot, kërkuaq sqarim BNT Electronics, si distributori zyrtar i Toshiba Tec Germany për territorin e Shqipëris, për mënyrën sesi vlerësohet origjinaliteti i tonerave të kësaj kompanie si dhe elementët e sigurisë që disponohen në bojrat e printerave, vendndodhja e tyre dhe mënyra sesi paraqiten. Në datë 17.08.2020, me shkresën nr. 6255 prot, distributori zyrtar i autorizuar i Toshiba Tec Germany për territorin e Shqipërisë, vërtetoi se tonerat e tregtuar janë origjinal dhe të prodhuar nga Toshiba, për tonerat e kërkuar nga autoriteti kontraktor FSDKSH”*. Për sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk me anë të dokumentacionit dhe mostrave të paraqitura fizikisht për zërat nr. 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17, dëshmon si dhe plotëson kriterin për paraqitjen e mostrave për zërat e mësipërcituar si dhe specififikimet teknike për këto mostra. Në këtë kuptim KPP gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se operatori ekonomik InfoSoft Office shpk i renditur i pari nuk ka paraqitur mostrat për zërat “nr. 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17, si dhe Modeli i Tonerit/Part Numberi duhet të jetë i stampuar në kuti dhe të jetë i njëjtë sipas shtojcës “Specifikimet Teknike” gjë që nuk është zbatuar nga “Infosoft Office”, nuk qëndron në rastin konkret pasi në dokumentacionin e dorëzuar nga operatori “Infosoft Office” shpk si dhe verifikimi i mostrave të paraqitura fizikisht pranë KPP nga ana e autoritetit kontraktor me shkresën nr 7444/1 prot, datë 12.10.2020, protokolluar me tonën me nr. 1065/4 prot, datë 13.10.2020, rezulton se janë paraqitur mostrat fizikisht për zërat nr. 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17 në përputhje me specififikimet teknike sikundër është kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Erisoni Company” shpk nuk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Erisoni Company” shpk mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “InfoSoft Office” shpk në procedurën e prokurimit objekt ankimi me arsyetimin se *“Modeli i tonerit i paraqitur ne katalog per artikullin nr 14 per printerin OKI MB 472dë nuk perputhet me printerin e kerkuar ne specififikimet teknike. Pait numberi i tonerit 45807111 i ofruar nuk i perket modelit te printerit OKI MB 472 dë te kerkuar ne specififikimet teknike dhe nuk eshte i perdorshem per kete lloj printeri”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se

III.6.1. Në shtojcën 9/2 *“Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”* pika 2.3/b *“Kapaciteti teknik”* të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

b) Për vlerësimin e ofertës teknike, Operatori ekonomik duhet të dorëzojë pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ne AK mostrat e produkteve sipas zerave me nr. 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17, te listës se artikujve të kërkuar në këtë procedurë prokurimi ditën dhe orën e zhvillimit të tenderit të shoqëruar me autorizim dhe me procesverbalin e dorëzimit të artikujve. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të

kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

• Ky do të jetë një kusht për skualifikim në rast se nuk do të paraqiten mostrat, do të ketë mangësi në produktet e dorëzuara ose nuk do ketë përputhje me specifikimet teknike të kërkuara.

Per artikujt qe nuk kerkohen mostra, te paraqitet katalog/broshure, ku te shprehet qarte, me foto, specifikime dhe part number, toneri qe oferton.

III.6.2. Në shtojcën 10, “Specifikimet teknike”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar si më poshtë vijon:

Specifikimi i Materialeve dhe Sasitë e parashikuara për prokurim, Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Nr.	PRINTER & FOTOKOPJE	MODELI I TONERIT	Nr.Kopjeve	Njesia	Sasia e pritshme
1	Toner per printer HP LaserJet 1150	(Q2624A)	2500	cope	10
2	Toner per printer Oki B430	43979202/43979211	7000	cope	1
3	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (black)	TFC26SK3 K	3000	cope	34
4	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (color)	TFC26SC2K	2000	cope	24
5	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (color)	TFC26SM2 K	2000	cope	24
6	Toner per fotokopje Toshiba e - Studio 222 CP (color)	TFC26SY2 K	2000	cope	24
7	Toner per printer Xerox Phaser 3600	106R01371	14000	cope	94
8	Toner per printer Xerox Phaser 3250	106R01374	5000	cope	161
9	Toner per printer Kyocera P2135	TK-170	7200	cope	211

	DN				
10	Toner per printer Lexmark MS310/312dn	50F2H00	5000	cope	73
11	Toner per printer HP Laserjet Pro 400MFP	CF280X	6900	cope	50
12	Toner per fotokopje Ricoh Aficio MP 301SP	Type MP301E	8000	cope	10
13	Toner per printer Xerox Phaser 3025	106R02773	1300	cope	12
14	OKI MB 472 dnë	45807111	12000	cope	12
15	Toner per Fotokopje Toshiba E studio 307	T5070E	36600	cope	134
16	Toner per Fotokopje Xerox Ęorkcentre 5330	006R01160	30000	cope	3
17	Toner per printer Xerox Versalink B7030	106R03396	30000	cope	20
18	Toner per printer KYOCERA FS6525MPF	TK -475	15000	cope	12
19	Toner per printer Xerox Ęorkcentre 3335	106R03623	15000	cope	10

Mosplotësimi i specifikimeve për çdo artikull përbën kusht skualifikimi.

Për vlerësimin e ofertës teknike, Operatori ekonomik duhet të dorëzojë pranë Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ne AK mostrat e produkteve sipas zerave me nr. 3, 7, 8, 9, 10, 11, 15, 17, te listës se artikujve të kërkuar në këtë procedurë prokurimi ditën dhe orën e zhvillimit të tenderit të shoqëruar me autorizim dhe me procesverbalin e dorëzimit të artikujve. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit

Ky do të jetë një kusht për skualifikim në rast se nuk do të paraqiten mostrat, do të ketë mangësi në produktet e dorëzuara ose nuk do ketë përpunje me specifikimet teknike të kërkuara.

Per artikujt qe nuk kerkohen mostra, te paraqitet katalog/broshure, ku te shprehet qarte, me foto, specifikime dhe part number, toneri qe oferton.

III.6.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk në përmbushje të kriterit dhe specifikimeve sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve teknike.
- Katalogë/broshurë për artikujt që nuk janë kërkuar mostra.

III.6.4. Në nenin 23, pikat 1, 2 dhe 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se : “1. *Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.* 2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të njëjtë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.* 3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke iu referuar: a) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve; b) kërkesave në terma funksionalë, kur një gjë e tillë kërkon t’u referohesh standardeve kombëtare ose ndërkombëtare, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale; c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni për mallra, shërbime apo punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*”

III.6.5. Në nenin 27, pika 1 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se “*Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPPdhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara*”.

III.6.6. Në nenin 46, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.* b) *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”*”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha*”

kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.6.7. Në nenin 55, pika 2, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet: *“2. Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit.”.*

III.6.8. Në nenin 27 “Kontratat e Mallrave”, të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikohet shprehimisht: Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.6.9. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës barazisë, dhe mosdiskriminimit janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato.

III.6.10. KPP pas shqyrtimit në tërësi të dokumentacionit të dorëzuar nga ankimesi vëren se nuk ka mospërputhje midis specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe specifikimeve teknike të pasqyruara në katalogët/broshurat teknike të operatorit ekonomik InfoSoft Office. Konkretisht KPP konstaton se specifikimi teknik për modelin e toneri 45807111 për prinetrin OKI MB 472 dnë gjen pasqyrim dhe është i njëjtë si në

katalogun/broshurën e dorëzuar nga operatori ekonomik “InfoSoft Office” shpk, duke përmbushur në këtë mënyrë kriterin në lidhje me përputhshmërin e specifikimit teknik për të cilën operatori ekonomik ankimes pretendon se nuk është përmbushur nga operatori ekonomik InfoSoft Office shpk, KPP konstaton se dokumentacioni katalogë/broshurë teknike dëshmon qartë se modeli toneri 45807111 për prinetrin OKI MB 472, i ofruar nga operatori ekonomik InfoSoft Office është në përputhje dhe përmban të njëjtat parametra me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat standarte të tenderit. Në kushtet kur operatori ekonomik ankimes ngren pretendime në lidhje me mospërputhshmërin e kodit të bojës pavarësisht se ajo është e prodhuar nga i njëjti prodhues, e vërtetuar kjo më anë të korespondencës që autoriteti kontraktor ka patur me shoqërin BNT Electronics distributori zyrtar i autorizuar i Toshiba Tec Germany për Shqipërin me përmbajtje si më poshtë *“Në datë 13.08.2020 me anë të shkresës nr 6243 prot, kërkuam sqarim BNT Electronics, si distributori zyrtar i Toshiba Tec Germany për territorin e Shqipërisë, për mënyrën sesi vlerësohet origjinaliteti i tonerave të kësaj kompanie si dhe elementët e sigurisë që disponohen në bojrat e printerave, vendndodhja e tyre dhe mënyra sesi paraqiten. Në datë 17.08.2020, me shkresën nr. 6255 prot, distributori zyrtar i autorizuar i Toshiba Tec Germany për territorin e Shqipërisë, vërtetoi se tonerat e tregtuar janë origjinal dhe të prodhuar nga Toshiba, për tonerat e kërkuar nga autoriteti kontraktor FSDKSH”*, përmban të gjitha elementët e sigurisë të kërkuar në dokumentata e procedurës së prokurimit objekt ankimi, në asnjë rast nuk pohohet dhe as provohet nga operatori ekonomik ankimes me fakte mungesa e origjinalitetit të bojës të dorëzuar nga operatori ekonomik Infosoft Office shpk, në asnjë rast nuk pohohet se boja e paraqitur nga ankimesi nuk përmbush specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi, pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimes në vlerësimin e Komisionit mbetet sipërfaqësor dhe të pabazuar. Autoriteti kontraktor i cili është dhe përfituesi drejtpërdrejtë i kontratës objekt ankimi ka gjykuar se produkti i paraqitur është në përputhje me specifikimet teknike dhe nuk provohet se produkti i paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Office” shpk nuk përmbush ndonjë nga elementët e specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik Infosoft Office shpk i plotëson specifikimet teknike të kërkuara dhe të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Erisoni Company” shpk nuk qëndron. Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Erisoni Company*” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-59740-06-03-2020, me objekt: “*Blerje artikuj tonera për printera dhe fotokopje*”, me fond limit/vlera e pritshme e kontratës 9,099,219 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 10.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Nr. 1065 Protokoli, Datë 04.09.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaid Myzyri